

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI⁴⁰, mbledhja e 10) me dt.29.09.2020 (e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planifikimit të Buxhetit për vitin 2021 dhe parashikimet për vitet 2022-2023
4. Dhënia në diskutim publik e Projekt Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës
5. Dhënia në diskutim publik e Projekt Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike
6. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e lëndës nr. C.nr.847/08 e dt.16.11.2011
7. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK Lazarevë:
 - a) N.T.SH "Tre"
 - b) N.SH. "A.M.C"
 - c) Kompania kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A. KEDS
 - d) N.T.SH. DIARI"
 - e) Bermas Therm SH.P.K.
 - f) Bimer Group SH.P.K.
 - g) A-D-E Group Sh.P.K
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.08.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Enver Gashi (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Fatos Kurshumlja, (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës dhe drejtorët komunal, Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës Janar – Qershor 2020
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Obiliqit për vitin 2019 – Zyra Kombëtare e Auditimit
5. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedi Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj)
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbim të pronave të cilat janë në pronësi të Komunës me pronat e paluajtshme në pronësi të Hashim (Rifat Berisha) në fshatin Bakshi
7. Shqyrtimi i Draft Rregullores për ndarjen e bursave kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe me kërkesën e z.Aziz Bici, që të futet si pikë në rendin e ditës ndarja e buxhetit për blerjen e maskave dhe shpërndarja e tyre falas për qytetarë. Kjo kërkesë është shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por nuk është rekomanduar për Kuvend sepse QKMF-ja, është duke shpërndarë maska falas, për ata qytetarë që kanë nevojë.

Aziz Bici – Unë me dt.24.08. e kam dorëzuar kërkesën, që do të thotë se paska pasë mundësi me shqyrtue KPF-ja. Pas kësaj unë kam kuptue se Komuna ka shpërndarë maska mbrojtëse për qytetarë, por nuk e di a e keni kuptuar se fjala këtu është për maska shumë përdorimëshe. Në rast se është fjala për maskën për një përdorim, atëherë nuk është qëllimi i kërkesës tonë sepse qëllimi është për maska shumë përdorimëshe, që qytetari mundet me pastrue. Kjo është arsyeja që ne kemi kërkuar dhe sa i përket rëndësisë së këtyre maskave, unë s’kam çka ju tregoj sepse ne jetojmë këtu në Komunë.

Kryetari – Ne e kemi shqyrtue kërkesën, por nuk e di sa jeni të informuar nga se tash i nisim procedurat për përgatitje edhe në Arsim, që do të thotë se shëndetësia dhe Arsimi janë tëmbuluar. Përveç tyre i kemi edhe maskat që vijnë si donacione, por maska një përdorimëshe dhe shumë përdorimëshe dallojnë. Mirëpo, ne si institucion komunal nuk mund ta shpërndajmë asnjë maskë e cila nuk është e testuar. Shpresoj se të drejtën e kodit për covid 19, e kemi gjithëherë mundësi me procedura më të shpejta për çështjen e alokimeve të mjeteve. Tash, janë 2, ose 3 procedura në proces.

Pas sqarimeve të dhëna, me 17 vota për aprovet rendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Mungoi: Lulzim Sadiku me leje

Pika e 2 e rendit të ditës

Aziz Bici – Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar në pikën e rendit të ditës “Të ndryshme” në deklaratat për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, hartuar dhe propozuar për votim nga z.Lulzim Sadiku sepse ajo që është shkruar ka gabime, dikund nga mesi është shkruar zona operative e fshatit të UÇK-së. Sa për informatë për juve, Kosova gjatë luftës, ka qenë e ndarë në 7 zona dhe zona për të cilën unë kam folë ka qenë zona operative e Shalës së UÇK-së, e cila me përgjegjësinë e vet komanduese ka pasë disa fshatra të Komunës së Obiliqit, Vushtrrisë dhe Mitrovicës. Prandaj kërkoj që të korrigjohet ky gabim.

Me 20 vota për miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjen e cekur më lartë.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju materialin e keni marrë dhe shihet qartë se është bërë një punë e jashtëzakonshme nga Ekzekutivi i Komunës, duke e përmbyllë pak a shumë bilancin në mes të hyrave dhe shpenzimeve.

Nazmi Gashi – Në raport nuk është përfshirë e gjithë puna që është bërë dhe këtu, fajin e kanë drejtorët e jo Kryetari, por herave tjera duhet të përfshihet në raport tërë aktiviteti që është bërë.

Kryesuesi – Në KPF, është diskutuar vëllimi i punës, por kësaj radhe ka marrë vëmendje menaxhimi i covidit 19, dhe DSHMS-ja, bashkë me Kryetarin dhe me shtabin emergjentë kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në këtë drejtim.

Kryetari – Ne po vazhdojmë me shvillimin e punimeve dhe sa i përket pandemisë, fatmirësisht në aspektin e përgjithshëm jemi në rregullë. Ne e dijmë të gjithë se te të hyrat vetanake është një problem i theksuar për shkak të pandemisë në të gjitha Komunitat, por në aspektin e zhvillimit të punimeve të gjitha projektet janë nisë dhe ato që nuk janë nisë janë në proces sipas planifikimit.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet raportin përfundimtar të auditimit për vitin 2019, nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Raporti është i pamodifikuar dhe pa asnjë theksim të çështjeve, që mund të them se është një ndër raportet më të mira në 10 vitet e fundit nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Unë e përgëzoj Kryetarin dhe Drejtoritë komunale për punën që e kanë bërë. Këtu, ia vlen të falenderohet Kryetari për angazhimin e tij që ka punuar me grupin për monitroimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit në vitin e kaluar, e cila sa i përket çështjes së rekomandimeve ka rezultuar të jetë pozitive.

Fatos Kurshumlja – Përderisa organi profesional e ka dhënë mendimin e vet, ne nuk kemi vërejtje.

Pika e 5 e rendit të ditës+

Kryesuesi – Paraqet Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedi Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj). Ne e kemi shqyrtuar në mbledhjen e KPF-së, këtë Propozim Vendim të Kryetarit dhe këtu bëhet fjalë për shpalljen e parcelës kadastrale me interes të përgjithshëm publik, jo për dhënien në shfrytëzim, por të këmbehet prona 4 ari e gjysmë në mes të biznesit dhe Komunës.

Enver Gashi – Ne e kemi shqyrtuar këtë kërkesë dhe jemi për këtë këmbim të pronës sepse është edhe interes i Komunsës, sepse një rrugë pa krye duhet të kthehet në rrugë funksionale që e përmirësojmë një operator me zhvillue një biznes, që kemi dobi prej tij edhe në punësim. Mendoj se ne si Kuvend duhet ti japim përparësi dhe mundësi biznesit, i cili e zhvillon aktivitetin e tij në Komunën tonë, prandaj si grup parlamentar jemi për përkrahje të këtij biznesisi.

Hysni Mjeku – Ne e kemi shqyrtuar këtë Propozim Vendim të Kryetarit në mbledhjen e KPF-së dhe jemi për përkrahje të biznesit.

Fatos Kurshumlja – Ne si grup jemi kundër, por po çuditë me grupin e Aleancës sepse në mbledhjen e kaluar ishin kundër gjysma e grupit dhe tash e paskan ndërrue mendimin. Ne në mbledhjen e kaluar kemi mbetë të na sjellet një material më detal se çka ka investuar ai që me pasë një thirrje gjatë kësaj periudhe për biznese me mbajtë takim.

Aziz Bici– Edhe ne do të jemi kundër për arsye se edhe në seancën e kaluar, jo pse kemi votuar kundër, por se është premtue të na sjellet material që të dijmë se çka po bëjmë. Unë për vete e kam konstatue se aty ka vend dyshimi për keqpërdorim në të kaluarën, prandaj edhe do të jemi kundër.

Armend Rushiti - Ne në mbledhjen e kaluar, e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës dhe kemi kërkuar që të na sjellet materiali më i kompletuar dhe sa i përket kësaj séance, ne end enuk kemi vendosë.

Nazmi Gashi– Unë në mbledhjen e kaluar e kam dhënë mendimin e plotë, por nuk kam qenë mirë i informuar. Mirëpo, me kompletimin e materialit po shihet se është shumë e logjikshme që diçka që nuk shfrytëzohet, diçka që nuk është në shërbim të qytetarëve, të ndërrohet pozicioni i asaj rruge që të shfrytëzohet ajo hapësirë.

Labint Mirena – Z.Fatos, është e vërtetë se ne jemi grup parlamentar i madh dhe ne mund ta shprehim mendimin e lirë secili dhe kur e kemi ndonjë hezitim apo keqkuptim ne e diskutojmë. Mirëpo, edhe pse je ti vet si grup i LDK-së, neve na ke prapa.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për, 4 vota kundër dhe 1 votë abstnienim e aprovuan Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedi Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj).

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës për këmbim të pronave të cilat janë në pronësi të Komunës me pronat e paluajtshme në pronësi të Hashim (Rifat Berisha) në fshatin Bakshi.Ju e dini se para 2 viteve, është marrë një propozim i tillë, por për shkak të akteve nënligjore që nuk e rregullonin këtë çështje, nuk është bërë këmbimi i pronës publike me atë private, e cila ka qenë kërkesë e komunitetit të Bakshisë. Mirëpo, tash me plotësim ndryshimin e ligjit për dhënien e pronave në këmbim iu ka mundësue Komunave, me realizue këtë çështje.

Enver Gashi – Ne edhe atëherë para 2 viteve, kur ka qenë kjo kërkesë e komunitetit të Bakshisë, kemi qenë për sepse është interes i joni dhe i komunitetit për një këmbim. Tash e kemi shpalljen e zonës me interes të veçantë dhe e përkrahim këtë kërkesë.

Hysni Mjeku – Këtë kërkesë e kemi shqyrtuar edhe më heret dhe jemi çdoherë pro interesave të qytetarëve.

Fatos Kurshumlja – Edhe ne e përkrahim këtë kërkesë.

Aziz Bici – Herën e kaluar kemi qenë kundër për arsye sepse atëherë ka qenë kërkesa e drejtuar prej komunitetit, jo prej institucionit dhe sa e di unë atëherë ligji këtë nuk e lejonte. Mirëpo, i kam pasë disa vërejtje tjera, nënshkrimet e banorëve të këtij fshati për mua nuk kanë qenë bindëse. Sigurisht se ne do ta votojmë këtë propozim vendim. Unë iu bëjë thirrje të gjithë anëtarëve të Kuvendit komunal, që kushdo që të merrë iniciativë në të ardhmen, qoftë ne si grup parlamentar Vetëvendosje, qoftë LDK, që fshatrave të cilave iu mungojnë hapësirat për ndërtime, qoftë të fushave sportive, qoftë të shkollave dhe të Shtëpive të kulturës, në të ardhmen mos t i lejojmë të ikë koha, por të ju sigurojmë këto hapësira.

Kryesuesi – Është e mirë se vetë komuniteti dhe qytetari në fjalë janë të gatshëm me bë këmbimin e pronës.

Aziz Bici – Unë këtu, në fund e pata fjalën për pronat që jemi duke i dhënë për 99 vite.

Dragan Dancetovic – Mendoj se Kadastri në Komunën tonë ka shumë problem dhe unë e shfrytëzoj rastin

që ta lus drejtorin e Kadastrit dhe organet përgjegjëse si dhe Kuvendin si organ më të lartë të Komunës, që kur janë në pyetje çështjet kadastrale ti zgjidhim sa më shpejtë dhe sa më mirë. Ekziston kërkesa që nga shtatori i vitit të kaluar e nënshkruar nga 7 banorë të fshatit Baimoc dhe kjo lëndë ende nuk është zgjidhur. Apeloj që qytetarëve të ju dalim në ndihmë që përveç rrugëve që janë të ndërtuara në qytet ne të iu dalim në ndihmë qytetarëve edhe nëpër fshatra në mënyrë që ata të kenë mundësi ti punojnë tokat e tyre.

Kryesuesi – Ne e kemi kërkesën e Kushtrim Ratkocerit që e ka dërgue në emër të komunitetit të Baimocit, dhe kjo kërkesë është shqyrtue në KPF, kështu që presim përgjegje për zgjidhjen e problemit të rrugës që e keni me Ibër Lepencin, për punimin e tokave që i keni pasë në vazhdimësi. Prandaj, besoj se në mbledhjen e radhës të Kuvendit, DPUKP, do të na sjellë një përgjegje..

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për dhe me 2 vota abstenim e aprovuan Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronave të cilat janë në pronësi të Komunës me pronat e paluajtshme në pronësi të Hashim (Rifat Berisha) në fshatin Bakshi.

Pika e 7 e rendit të ditës

Kryesuesi - Paraqiti shqyrtimin e Draft Rregullore për ndarjen e bursave kompensimin e shpenzimeve të ushëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore. Në mbledhjen e KPF-së, në veçanti është folë për kriteret për dhënien e bursave në studimet master, që ato drejtime të jenë si prioritet, por mos të iu mohohet e drejta të tjerëve.

Enver Gashi – Ne e kemi shqyrtue këtë Draft Rregullore dhe e përkrahim miratimin e saj me vërejtjet e dhëna në KPF.

Hysni Mjeku – Ne si Komision dhe si grup parlamentar i PDK-së, e përkrahim ndryshimin e kësaj Rregulloreje me rëndësi të veçantë.

Fatos Kurshumlja – Edhe ne e përkrahimin ndryshimin e Rregullore në fjalë.

Aziz Bici – Ne me shkrim iu kemi drejtue edhe drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, me propozimet tona Te neni 3, shumta financiare lartësia e shumës financiare për bursë duhet të caktohet me një Komision profesional i cili duhet të themelohet për këtë çështje. Në asnjë mënyrë nuk ka pse ti jepet ekskluzivitet një njeriu, qoftë edhe ai i Kryetarit të Komunës. Neni 6, shpallja e konkursit pika 2, ne konsiderojmë se 15 ditë janë pak, prandaj propozojmë që konkursi të jetë i hapur për 30 ditë, në mënyrë që mos të shkaktohen radhë për shkak të pandemisë covid 19. Neni 8, Kushtet dhe kriteret për të fituar bursë studentët, pika 1,2, në profilet e fakulteteve për ndarjen e bursave në nivelin master të përfshihet edhe kimia. Neni 14, ndarja e çmimit sipas kriterëve të njëjta, ndarja e çmimit të studentëve më të dalluar të vitit më short të vendosur nga Kryetari, në rast se kandidatët e mundshëm kanë kriteret e plotësuar njësoj është e papranuar. Nëse, studentët janë të aftë për këtë çmim, i kanë kriteret e plotësuar njësoj, të specifikuar me nenin 13, atëherë ne propozojmë që çmimi i studentëve më të dalluar të vitit ti takoj studentit i cili e ka qoftë edhe një trajnim më shumë. Neni 16, duhet të ceket qartë se 3 vendet e para në nivel komunal dhe të Republikës duhet të shpërblehen me njëren dhe lartësia e shpërblimit të caktohet nga një Komision i veçantë të specifikuar qartë se shpërblimi do të jetë i garantuar në rast suksesi dhe jo të varet nga vendimi i Kryetarit. Neni 26, procedurat e pagesave, pika 2 të specifikohet afati kohor në realizimin e pagesave, jo të thuhet në kohë sa më të shkurtë. Realizimi i pagesave të bëhet brenda 10 dite, nga data e nënshkrimit të kontratës nga përfituesi i bursës. Do të thotë se me këto ndryshime ne sigurisht se do ta votojmë.

Armend Rushiti – Edhe ne e përkrahim këtë Draft Rregullore.

Nazmi Gashi – Ne si anëtarë të Kuvendit, nuk kishim të drejtë të jemi në snjë Komision dhe qysh mundemi me kalie Rregullore përmes Kuvendit, ndërsa anëtarët e Kuvendit mos me qenë në Komision. Kjo, nuk është e logjikshme dhe jo që ne bëjmë pengesë, por është nder dhe respekt. sepse Ekzekutivi i Komunës dhe administrata ka mjaft punë dhe është mirë që ne të iu ndihmojmë atyre sepse në një Komision kemi qenë unë, z.Hysni dhe z.Muhamet rreth 2 nxënësve të Orloviqit, për pagesë të studimeve. Ne edhe pse e pamë se është e drejtë për pak mjete Rregullorja nuk lejonte me iu ndihmue dhe tash kjo çështje është e rregulluar me Rregullore. Neve, çka na duhen arsimtarët, çka na duhen objektet nëse, nuk kemi nxënësia sepse duhet ti

lutim nxënësit e Komunave tjera, me iu ndihmë në çdo formë për me i sjellë këtu. Nëse, na shkojnë nxënës atëherë, çka me iu thënë arsimtarëve. Unë besoj se kualiteti i Arsimit në Komunën tonë është i mirë, stafi është i mirë dhe ne kemi rezultate të mira. Qëllimi i këtij Kuvendi është shumë pozitiv dhe për këtë janë rezultatet e mira në krahasim me Komunitet tjera, kështu që ne duhet të përfundojmë me një mirënjohje të madhe në tërësi si kolektiv, por edhe si individ njerëzit duhet të respektohen.

Kryesuesi – Te shpallja e konkurseve neni 6, është çështje teknike administrative 15-30 ditë dhe kjo është e bazuar në ligj. Kriteret për ndarjen e çmimit, ju e dini se studenti i dalluar apo studenti me titull me çmimin “Adem Preniqi” e merrë dyfishin e bursës së një studenti të dalluar. Ndarja e shpërblimeve për 3 vendet e para, Komisioni i ka kriteret e veta të përcaktuara me ligj dhe aktet tjera nënligjore. Te caktimi i shumës së bursave, nuk duhet të harrojmë një gjë se Kryetari i Komunës, është zyrtari kryesor financiar dhe kjo Rregullore nuk bëhet për Kryetarin, por për nxënës e studentë.

Rexhep Zeka – Ne e kemi bërë kërkesën për plotësim ndryshim të Rregullores për bursa dhe tash po i drejtohem z.Nazmi Gashi, se e kemi bërë publike edhe në web faqe të Komunës, kur iu kemi drejtue juve si Kuvend dhe të gjithë qytetarëve, që secili prej juve nëse, vetëm një prje e vendosni ne jemi mirënjohës. Kjo Rregullore ka qenë në diskutim publik dhe ne jemi munfuar ti marrim të gjitha informatat në mënyrë që të delë një Rregullore më e përsosur. Ne këtë vit duhet të dijme sa mjete i kemi dhe të planifikojmë diçka për vitin 2021, pastaj ta caktojmë shumën financiare dhe këtë vendim e merrë i zoti i shtëpisë. Shpallja e konkursit është 15 ditë pune. Te ndarja e çmimit sipas kriterëve të njëjta vendos Komisioni sepse nëse, e bën Kryetari atëherë kjo punë është punë shumë e ulët. Ne si Komunë me 20,000 banorë me u bë një Rregullore që përfitojnë 124 bursa studimet themelore, ndërsa Prishtina me 600,000 banorë i kanë ndarë 120 bursa, tash ku është përpjesëtimi aplikues dhe përfitues. Ne në konkurs nuk kemi vendos kriter për sjelljen e llogarisë bankare sepse nuk kemi dashtë ti lodhim studentët tme hapë konto dhe ndoshta nuk janë përfitues. Mirëpo, kur të shpallet lista fituese aty, i obligojmë me shkrim që me i hapë llogaritë bankare. Bursat gjithmonë ndahen në fund të vitit kalendarik dhe përtej 15 dhjetorit, nuk kemi nga të shkojmë ne deshtëm apo nuk deshtëm gjithmonë fiks kemi me qenë me kohën për me bë realizimin e buxhetit.

Aziz Bici – Te neni 3, ne kemi propozue që të jetë një Komision profesional dhe ne kemi aludue se ky Komision ti ketë parasysh shumë faktorë sepse jam i vetëdijshëm se Kryetari i ka të gjitha kompetencat, me ligj Kryetari votohet për Kryetar ndërsa ne anëtarët e Kuvendit, kemi përgjegjësi tjera. Mendoj se është në interes të kësaj Rregulloreje, është edhe në interes të Kryetarit, të ceket që të jetë një Komision profesional sepse unë jam i vetëdijshëm se munden me bashkëpunue dhe kjo është shumë normale. Për këtë arsye, jo vetëm me thënë formalisht të jetë Rregullorja sa më profesionale, por mendoj se të merret përgjegjësia e përbashkët e një Komisioni së bashku me Kryetarin.

Kryesuesi – Në mbledhjen e KPF-së, është bërë ky ndryshim ku thuhet se Kryetari i Komisionit, në bazë të raportit të Komisionit vlerësues merrë vendim dhe cakton shumën financiare.

Aziz Bici – Sa i përket 15 -30 ditë, ne kemi menduar vetëm për shkak se jemi me pandemi, jemi me covid 19. Nëse, mendoni ju se këto procedura me dokumentacion duhet me i plotësue nuk ka mjaft kërkesa, atëherë nuk është patjetër që të jetë 30 ditë, por mund të jetë edhe 15 ditë.

Kryesuesi – Tani e hudhi në votim aprovimin e Draft Rregullores për ndarjen e bursave kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore me rekomandimet e KPF-së, ku janë përfshirë të gjitha ndryshimet që i përmendëm.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Rregulloren për ndarjen e bursave kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Pika e 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me kërkesat të cilat në mbledhjen e KPF-së, iu kanë drejtue Drejtorive përkatëse për shqyrtim, pastaj në mbledhjen e radhës të na kthehet një përgjegje. Një kërkesë e kemi pasë nga Fatmir Rexhepi, tashmë i ndjerë dhe ai ka kërkuar një vendim të Kuvendit komunal të vitit 2011, rreth një kioske, kështu që ne duhet ti kthejmë përgjegje brenda afatit kohor.

E kemi një kërkesë për transfere dhe rialokime nga DEFZH-ja, nga mbetjet e mjeteve pas lidhjes së kontratave:

1. Investimet Kapitale 2020 transfere dhe rialokime në vlerë prej 110,817.35 €
2. Nga rezervat e pagave 480,116.83 €, kalojnë në
 - Pagat jubilarë në vlerë prej 139,100.48 €,
 - Laborator për analiza për teste të COVID-19, në vlerë prej 15,000 €,
 - Subvencione për dëmet nga të reshurat e shiut 100,000 €,
 - Infrastrukturë në vlerë prej 150,000 €, dhe
 - Mallra dhe shërbime për COVID-19, në vlerë prej 76,016.35 €,

Enver Gashi – Ne si grup e kemi trajtue këtë kërkesë dhe e përkrahim.

Fatos Kurshumlja – Unë vetëm kaiha dashur me ditë se a është arritë të vlerësohet dëmiqë është bërë nga të reshurat.

Kryesuesi – Përgjegjet se në mbledhjen e radhës do të na sjellë me shkrim Komisioni vlerësimin e dëmeve totale dhe është thënë se dëmet bujqësore shkojnë mbi 500.000-600,000, por Komuna me i nda 200,000 euro, kjo nuk ka ndodhë kurrë në histori për kompensimin e dëmeve.

Armend Rushiti – Unë kisha dashur një përgjegje për mjetet që janë në shumën prej 150,000 që po rialokohen në infrastrukturë në cilën pjesë të infrastrukturës.

Kryesuesi – Përgjegjet se pjesa më e madhe shkojnë në sanimin e rrugëve, te kodi buxhetor që e kemi në zonat locale sepse edhe me dashtë kod të ri është problem me hap.Pra, do të shkojnë me kodin ekzistues, me prioritet dhe duhet të fillohen ato rrugë të sanohen në kuadër të kontratave ekzistuese që i kanë.

Armend Rushiti – Pyeti po te investimet kapitale në vlerën prej 110,117.35 €,

Kryesuesi – Përgjegjet se është e njejta, këto, mjete janë mbetjet nga projektet.

Nazmi Gashi – Ne kur e kemi bërë bartjen e mjeteve në buxhet, unë iu kam drejtue juve, personalisht dhe kam pyet se a do të ketë mbetje në projekte, a do të ketë ndryshime në projekte dhe a do të vazhdon marrëveshja që e kemi pasë. Ju kryesues më keni thënë se nuk kanë me mbetë projektet pa përfundue dhe unë nuk e kam ditë se Ministria, i ka marrë mjete Komunës. Tash. po dëgjoj se neve na mungojnë mjetet, pse na mungojnë. Kryetari vetë më ka premtime personalisht se kemi me bë parkun e gjelbërimit dhe pjesën sportive këru naltë dhe tash çka është bërë.

Kryesuesi – Përgjegjet se krejtë kemi pasë me i krye, por unë e thashë në fillim se plani i punës të Kuvendit ka pësue ndryshim për shkak të pandemisë covid 19 dhe Zyra e Prokurimit, afër 4 muaj ditë nuk ka mund asnjë projekt me hapë. Ne jemi në vazhdimësi por pak me vonesë dhe plani i zhvillimeve në raport me të hyrat në investime vetëm në muajin e 9 mund të hyjmë.

Nazmi Gashi – Pyeti a janë mjetet.

Kryesuesi – Përgjegjet po, mjetet janë dhe unë nuk e di është DEFZH-ja, e cila menaxhon Kryetari i Komunës, por e di një gjë se objekti për komunitet në Sibofc, në lagjen Gashi, objekti për komunitet në Dardhishtë, në Mazgit dhe objekti i vjetër në Sibofc, te shkolla me vendim i kemi ndarë 150,000 €, për me i rindërtue dhe kthye në emër të komunitetit. Mendoj se DSHPE-ja, e ka në plan me krye këtë vit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për e aprovuan Vendimin për transfere dhe rialokime nga DEFZH-ja, nga mbetjet e mbetura pas lidhjes së kontratave.

Pika e 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim të gjerë rreth dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut, fjalën ia dha drejtorit të Drejtorisë për bujqësi dhe zhvillim rural.

Bejtullah Mjekiqi – Ne siç e dijmë reshjet kanë qenë me dt.17, dhe kryesisht dëmet më të mëdha kanë qenë në fshatin Baimoc, Raskovë, Breznicë dhe Kozaricë. Menjëherë me dt.18, ka dalë një Komision i cili e ka verifikuar gjendjen faktike duke parë se dëmet më të mëdha janë në bujqësi. Me dt.19, ne e kemi formuar Komisionin vetëm për dëmet e bujqësisë. Ky Komisioni ka bërë vlerësimin e të gjitha parcelave dhe i kemi udhëzuar fermerët që të bëjnë kërkesa me fotografi. Dëmet janë shumë të mëdha, kryesisht në specat dhe kultura tjera, po flas për fshatin Baimoc dhe Raskovë, ndërsa në Breznicë ka edhe në kultura tjera bujqësore. Ne raportin e Komisionit bashkë me kërkesën e Kryetarit e kemi dërguar menjëherë në Ministri me dt.25, ku

kemi pasë takim me ministrin e bujqësisë dhe kemi kërkuar përkrahjen e tyre. Ata e kanë një fond prej 3 milion €, për dëme, por siç e dijmë edhe në Komunat tjera, ka pasë shumë dëme. Dëmet kur kanë qenë në pranverë prej breshërit kanë paguar dikund rreth 25 %, në vlerë të dëmit dhe tash a mjaftojnë ato të kompensohen me 25 %, të vlerës së dëmit, apo 20 % mbetet të shihet. Në Komunën tonë vetëm dëmet në bujqësi janë dikund rreth 596,000 €. Dëmet kryesisht në fshatin Baimoc dhe Raskovë në specia janë mbi 80 %. Të gjitha vlerësimet e dëmeve janë përcjellë në Ministri dhe tash presim përkrahjen prej tyre.

Naim Miftari – Është e vërtetë, se kemi pasur disa dëme në infrastrukturën rrugore dhe në kanalizim dhe këto dëme më shumë kanë qenë në Breznicë dhe Kozaricë. Ne si Drejtori kemi ndërmarrë masat e menjëhershme, por duhet të punohet ende në sanimin e atyre rrugëve dhe shpresoj se do të sanohen të gjitha dëmet që janë bërë gjatë reshjeve të shiut.

Hysni Mjeku – Banorët e fshatit Grabofc i Epërm, e kanë pasë një kërkesë që nga viti 2018, lidhur me segmentin e rrugës regjionale Grabofc i Ulët – Drenas. Ne që jetojmë atje dhe veprojme faktikisht jemi në një rrezik të madh sepse shpejtësia e vozitjes është enorme. Unë afërsisht me 100 nënshkrime të banorëve kam kërkuar që mundësisht të ndërmerren disa masa edhe me shtrirje të policëve në rrugë, në mënyrë që shpejtësia e automjeteve të kufizohet. Ne kemi përgjegje nga Ministria përkatëse, se këtë çështje duhet ta rregulloj pushteti lokal. Pas kërkesës time kërkoj ti jepet fjala qytetarit të Grabofc-it të Epërm, që detalisht ta sqaron çështjen.

Nehat Mjeku– Unë kërkesën e kam bërë në vitin 2018 në Komunë dhe në Ministrinë e infrastrukturës. Rruga jonë në fshatin Grabofc, që e lidhë Drenasin me Bellaqevcin, është një rrugë shumë e mirë, por me nivel të rrezikshmërisë së lartë sepse më se 60-70 %, shumica e transporteve bëhen andej. Po ashtu, ka pasë raste kur veturat kanë hy në oborre të fshatit, janë 2 raste që i kanë goditë edhe kafshët, ndërsa në rastin e fundit ka qenë një ndeshje me motor ku kanë vdekë 2 të rinjë. Disa masa janë ndërmarrë, por niveli i rrezikshmërisë nuk është ulë sepse nuk mjaftojnë në mentalitetin tonë me qenë një shpejtësi e kufizuar dhe shenjat vibruese. Kërkesa jonë është të vendosen policë të shtrirë dhe ju lus të ndërmerrni masa pasi që tash pritet edhe fillimi i vitit të ri shkollor dhe të mos kemi aksidente sidomos te fëmijët.

Kryesuesi – Për sqarim rreth kësaj çështjeje fjalën ia dha drejtorit të DSHPE-së.

Naim Miftari - Ne kemi punuar me projektin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal duke përfshirë edhe Grabofcin, por duhet ta keni parasysh se ajo është rrugë regjionale dhe Komuna, në rrugën regjionale nuk guxon të vendos policë të shtrirë. Deklarata e Ministrisë është në kundërshtim me ligjin për rrugët sepse ligji për rrugët, thotë se ajo rrugë që i lidhë 2 e më shumë Komuna, është rrugë regjionale.

Nazmi Gashi – Ne po gabojmë shumë me vendosjen e policëve të shtrirë sepse po i ikim masave ndëshkuese, po i ikim të hyrave dhe po i ikim kontrollit të policisë. Problemi nuk zgjidhet me vendosjen e policëve të shtrirë, por zgjidhet me mbajtjen e rregullave, me denime dhe me përcjellje permanente nga policia. Këtë e kam vërejtë nga pjesa e inspeksionit ku kam punue sepse aty ku kemi bërë kontrollë kemi qenë 100 % të suksesshëm. Unë dua ta paraqes edhe problemin në fshatin Sibofc, në muajt e fundit që është problem i mushkonjave dhe mendoj se aty, pusetat e kanalizimit duhet të pastrohen. Prandaj Drejtoria përkatëse duhet të merret me këtë çështje dhe ta zgjidhë problemin.

Fatos Kurshumlija – Në mbledhjen e qershorit kam pyet për rrugën në fshatin Lajthishtë dhe Hamidi dhe drejtori i infrastrukturës zakonisht nuk është këtu, ose po del më heret. Drejtori i DSHPE-së, përmendi se është duke u marrë me shenja të sinjalizimit, por te rruga që po bëhet kyqja te hekurudha që shkon te “Emona” dhe te rruga e re, është pa shenja sinjalistike dhe nuk e dijmë se kush ka përparësi. Dua, ta pyes se me çfarë të drejte, ose Rregullore i ka vendos ato vibrime pak më tutje te njëfarë mjeshtri është Tovërlani, sepse aty asnjëherë nuk ka pasë aksidente.

Naim Miftari – Z.Fatos, nuk jam ekspert i sinjalizimit dhe nuk jam inxhinjer i komunikacionit. Kërkesa e banorëve që jetojnë matanë hekurudhës, është trajtuar sepse ata po ndjehen të rrezikur, por nuk qëndron ajo që e the ti se nuk ka pasë aksidente sepse ka pasë aksident një kamion veç gati ka hy në një shtëpi banimi. Kjo është arsyeja që janë vendos ato vija vibruese.

Ľabinot Mirena – Pyet se a ka mundësi vijat vibruese me i vendos edhe në Grabofc.

Kryesuesi – Përgjegjet se në Grabofc, janë vendos vijat vibruese.

Dragan Dancetovic – Ju njoftoj se me dt.30, në fshatin Baimoc ka ndodhë një rrahje në mes të rinjëve dhe ajo që na brengos të gjithëve është se grupet janë të nacionaliteteve të ndryshme. Prandaj, e lus institucionin dhe policinë që problemin ta zgjidhin sa më shpejtë, që një problem individual të mos zgjerohet dhe të merrë përmasamë të gjera. Unë jam shumë i brengosur sepse në 4 gjeneratat e mëparshme incidente të tilla nuk kanë ndodhë asnjëherë. E gjykoj një ndodhi të tillë të sjelljes dhe e ndaj brengën e familjarëve sepse incidentet e tilla rrënojnë qëllimet e mira të sjelljes. Ne duhet shumë të merremi me këto probleme sepse janë në pyetje të rinjët dhe duhet më shumë të investohet në periudhën e ardhshme, sidomos kur janë në pyetje të rinjët dhe fëmijët në fshatin Baimoc, dhe ne faktikisht nuk kemi asnjë objekt sportiv.

Kryesuesi – Shpresoj se incidenti në fjalë të mos e merrë atë drejtim dhe organet e sigurisë sa më shpejtë ta zgjidhin rastin. Sa i përket fushave sportive, besoj se Drejtoria përkatëse, do të merrë këto vërejtje që u dhanë në mbledhje.

Shaip Paloja – Mendoj se rastet e kacafytjeve të të rinjëve këtu, nuk është mirë që ne ti politizojmë sepse janë raste që merren organet gjegjëse, policia e nëse ka nevojë edhe Gjykata. Te rasti i qytetarëve të Grabofc-it, unë solidarizohem shumë me ata sepse vërtetë u përmendë rasti që ka ndodhë me motoçikletë. Ndërsa, unë po e përmendi një rast tjetër që ka ndodhë aty, në vitin e kaluar autobusi i KEK-ut, e ka godit veturën dhe aty ka mbetë një njeri i vdekur. Mendoj se Drejtoria përkatëse duhet patjetër të bashkëpunoj me Ministrinë në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për këtë çështje. Te rasti tjetër, te hekurudha apo te unaza edhe pse është bërë një punë shumë e mirë që është asfaltue ajo rrugë aty, gjithmonë është rreziku permanent për aksidente. Aty, nuk ka shikueshmëri të mjaftueshme, shenja të përparësisë së kalimit nuk ka dhe është vendos një pasqyrë, por ajo është shumë e vogël. Mendoj se aty duhet të ndërmerret diçka patjetër sepse kur vjen te tragjedia atëherë është vonë. Unë kam një pyetje për DPUKP-në, në vitin e kaluar ne e dijmë se nga KEK-u, iu kanë kthye disa prona Komunës tonë dhe një prej tyre është një pronë në territorin e Palajve. Prandaj pyes se cila është ajo pronë që iu ka kthye Komunës, në atë fshat. Kërkoj zyrtarisht prej Drejtorisë përkatëse të japë shenime se cila është ajo pronë dhe ku gjendet.

Samire Berisha – Unë i kam 2 kërkesa, njëra për DKA-në dhe tjetra për DSHPE-në. Ne si Komunë vlerësohem si qytet industrial energjetik dhe kemi edhe shkollën “Ismail Dumoshi” e cila dikur ka pasur nxënës dhe peronel arsimor nga të gjitha vendet e Kosovës. Mirëpo, sot mjerisht qëndron ndryshe me një numër jashtëzakonisht shumë të vogël të nxënësve të cilët regjistrohen në klasën e 10, por në kuadër arsimor profesional. Duke marrë parasysh shumë për bazë

çdoherë kërkesën e KEK-ut, për punësimin e kuadrit të ri dhe implementimin e Ligjit për Obiliqin, banorët e Komunës tonë duhet të kenë më prioritet për punësim. Drejtoria e Arsimit, duhet të gjejë forma dhe mundësi që ti formoj të gjitha paralelet e drejtimit teknik të cilat kanë ekzistue më heret si drejtimi i makinerisë, elektros dhe i xehtarisë. Kërkesa e dytë është e qytetarëve dhe prindërve, të cilët me mjetet e tyre nxënësit i vijnë mësimit në shkollën “Dr.Ibrahim Rugova” dhe për ngritjen e sigurisë duhet të vendosen në rrugë pengesat teknike, konkretisht te rruga “Pjetër Bogdani”. Në këtë rrugë ka qarkullim të madh të qytetarëve, të cilët i bartin fëmijët në shkollë dhe vendosja e këtyre pengesave, do të kontriboj në sigurinë e qytetarëve.

Nora Preniqi – Unë e dëgjova më heret kolegun nga Nisma, që foli për mushkonjat në fshatin Sibofc, por shqetësimi i muskonjave është edhe në Obiliq. Unë deshta ta pyes Drejtorinë përkatëse, se a kanë ndonjë projekt për spërkatjen e tyre.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Në Komunën tonë që nga fillimi i pandemisë dezinfektimi dhe deratizimi është bërë 2 herë dhe këto kanë qenë kërkesat kryesore primare nga Ministria e shëndetësisë, IKSHP-ja dhe banorët. Sa i përket dezinfektimit, sot është afati i fundit i mbylljes së ankesave dhe është në procedurë të Prokurimit, kështu që pritret brenda kësaj jave të kryhet.

Mbledhja përfundoi në ora 12:27

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri